

RAPORTI I GREVIOS PËR SHQIPËRINË-PLAN VEPRIMI PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE QË PUNOJNË KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

RRJETI I MONITORIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE, i përbërë nga organizata jofitimprurëse aktive në fushën e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje synon monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit CEDAW¹, GREVIO-s² dhe UPR-s³, për Shqipërinë, duke ofruar kontribut në adresimin e boshllëqeve dhe raportimin progresiv për mekanizmat e konventës Mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave CEDAW, Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventës së Stambollit) dhe UPR, advokaci, lobim, etj.

Raporti i GREVIOS për Shqipërinë përmban rekomandime të rëndësishme për shtetin shqiptar dhe përbën një plan veprimi për organizatat e shoqërisë civile anëtare të këtij rrjeti dhe organizata të tjera.

Ky raport i Grupit të Ekspertëve mbi Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), vlerëson masat legjislative dhe masat e tjera të ndërmarra në zbatim të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit bazohen në informacionin që anëtarët e GREVIOS kanë marrë nga raporti shtetëror, informacionet shpesh të paraqitura nga disa OJF, dialogu shtetëror midis GREVIOS dhe autoriteteve shqiptare për një numër të caktuar të çështjeve si dhe një vizitë vlerësimi 5-ditore në Shqipëri, me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.

Në dhënien e rekomandimeve, GREVIO ka përdorur terma të ndryshme që i korrespondojnë niveleve të ndryshme të urgjencës, duke tërhequr vëmendjen se të gjitha janë të rëndësishme. Këto terma konsistojnë në: “kërkon” (veprime të menjëhershme kërkohen për të përqsur legjislacionin ose politikën e shtetit me Konventën e Stambollit, ose për të siguruar zbatimin e saj); “nxit fuqimisht” është përdorur për boshllëqe që nevojiten të rregullohen në të ardhmen e afërt, me qëllim që të sigurohet një zbatim gjithëpërfshirës i Konventës; “nxit”, është përdorur për boshllëqe që kërkojnë vëmendje, edhe pse në një fazë të mëvonshme; “fton” shënon boshllëqe të vogla në zbatim, për të cilat autoriteteve i është kërkuar t’i konsiderojnë dhe t’i mbyllin.

¹ Komiteti i Konventës së OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

² Grupi i pavarur i ekspertëve që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

³ Rishikimi Periodik Universal (UPR) i të dhënave të të drejtave të njeriut të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

GREVIO kërkon nga autoritetet shqiptare të ndërmarrin veprime të mëtejshme kundër dhunës ndaj grave (DHKG) duke siguruar që masat e marra adresojnë të gjitha format e DHKG.

GREVIO nxit fuqimisht autoritetet shqiptare të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë masa legislative, për të harmonizuar përkufizimin e dhunës në familje në legjislacionin e brendshëm me Konventën e Stambollit dhe për të siguruar zbatimin efektiv të përkufizimit të harmonizuar në praktikë.

GREVIO inkurajon autoritetet shqiptare: a.të vazhdojnë të bazojnë përpjekjet në luftën ndaj DHKG në politika në favor të fuqizimit të grave, në sferën publike dhe private dhe që sigurojnë barazinë substanciale midis burrave dhe grave.

GREVIO nxit autoritetet shqiptare të studiojnë mjetet e mundshme për të rritur ndërgjegjësimin rreth natyrës diskriminuese të DHKG dhe rritjen e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si mbrojtës të viktimave të DHKG.

Bazuar në detyrimet e parashikuara në nenin 8 të Konventës, (burimet financiare) autoritetet shqiptare nxiten fuqimisht të forcojnë makinerinë kundër DHKG, duke siguruar mjetet e duhura njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe vendor.

Autoritetet shqiptare inkurajohen fort të zgjerojnë konsiderueshëm buxhetin e autoritetit përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër DHKG, burimet për ministritë e linjës, përpjekjet në zbatimin e buxhetimit gjinor, alokimin e fondeve, monitorimin dhe matjen e progresit;

GREVIO inkurajon autoritetet: a.të shtojnë tregues specifikë në mbledhjen e të dhënave, në lidhje me grupet vulnerable të grave dhe vajzave; b.të integrojnë perspektivën e grupeve të tilla në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave për parandalimin dhe luftën ndaj DHKG; c. të integrojnë parandalimin dhe luftën kundër DHKG në programet për nevojat specifike të grupeve vulnerable;

GREVIO kërkon nga autoritetet shqiptare të ndërmarrin masat e duhura, si programe të përshtatshme dhe grante, procedura prokurimi transparente, që sigurojnë mbështetje financiare të qëndrueshme për OJF-të e grave që punojnë në mbështetje të viktimave dhe parandalimin e dhunës, duke mundësuar përmbushjen e nevojave të të gjitha viktimave.

Në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe studimeve, GREVIO inkurajon fort autoritetet shqiptare të bëjnë DHKG/DHF më të dukshme në statistikatat e krimeve; identifikimin e numrit të grave viktime, të llojit të krimit; marrëdhënien dhunues/viktimë; dënimet për të gjitha format e dhunës, numrin e urdhrave të mbrojtjes, gjininë, moshën, marrëdhënien e të gjitha palëve të përfshira, autorizimet e dhëna nga gjykata për martesat ne moshe te mitur si dhe bërjen publike të rezultateve të studimeve.

GREVIO kërkon nga autoritetet të sjellin sistemin e kujdesit shëndetësor në krye të përpjekjeve për të luftuar të gjitha format e DHKG; të ofrohet ekspertiza që në zbulimin e hershëm, të përmirësohen protokolle, të organizohen trajnime; të ngrihen qendra për viktime të dhunës seksuale, të forcohet bashkëpunimi i shërbimeve shëndetësore me aktorë të tjerë të Mekanizmit të Referimit dhe të rritet raportimi i rasteve të dhunës në familje;

Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit, GREVIO nxit fuqimisht autoritetet shqiptare të mbështesin dhe zhvillojnë më tej përpjekjet e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit në mbështetje të një mesazhi të përgjithshëm kundër dhunës. Duhet të zhvillohen fushata të synuara për: a. të rritur ndërgjegjësimin rreth dëmit që pësojnë fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje; b. të sfiduar normat, qëndrimet dhe stereotipat shoqërore në lidhje me statusin inferior të grave në njësinë familjare, të cilat kontribuojnë në pranimin e dhunës brenda familjes; c. të arritur tek grupet vulnerabël të grave dhe vajzave dhe për të trajtuar nevojat e tyre specifike.

Në lidhje me menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave në nivel vendor, GREVIO kërkon nga autoritetet shqiptare:

- Bashkëpunim ndërinstytucional në MR, i zgjeruar për të gjitha format e DHKG;
- Të gjitha bashkitë të ngrenë një mekanizëm funksional referimi;
- Të përmirësohet bashkëpunimi institucional midis të gjithë anëtarëve të MR, në mënyrë të veçantë punonjësve gjyqësor, zyra të përbarimit publike dhe private;
- MR të ofrojnë një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh;
- Qëndrueshmëri strukturore dhe financiare e MR, në terma afatgjatë;
- mësimet e nxjerra nga MR dhe ndarja e modeleve më të mira është e rëndësishme;

Gjithashtu, në lidhje me Shërbimet Sociale, GREVIO nxit fuqimisht autoritetet: a. të sigurojnë fondet e mjaftueshme për shërbimet sociale, që bashkitë ofrojnë për të mbështetur viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre afatshkurtra dhe afatgjata; b. të rrisin fondet dhe numrin e shërbimeve për integrimin ekonomik dhe fuqizimin social të grave viktime, përmes përfshirjes së ministrive të linjës dhe autoriteteve vendore. Këto shërbime duhet të mbështeten në qasje aktive, përfshirë garantimin e strehimit, ndihmës për gjetjen e punësimit dhe krijimin e kontaktit me bizneset.

Lidhur me legjislacionin civil, GREVIO nxit fuqimisht autoritetet shqiptare të miratojnë masa për t'u lehtësuar dhe garantuar viktimave të të gjitha formave të DHKG akses në kompensim, duke shqyrtuar procedurat penale dhe civile në lidhje me kompensimin nga autorët e veprave penale; duke siguruar që viktimat të informohen në mënyrë sistematike për të drejtën e tyre për dëmshpërblim; përmes garantimit efektiv në ndihmën dhe këshillimin ligjor.

GREVIO fton më tej autoritetet të vlerësojnë se cilat janë arsyet që pengojnë viktimat të kenë akses në mjetet juridike civile dhe marrin masa për të trajtuar shkaqet. GREVIO nxit autoritetet shqiptare të korrigjojnë në legjislacionin penal boshllëqet që lidhen me dhunën psikologjike, si

dhe të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave, në mënyrë që përkufizimi të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të rezistencës fizike por të bazohet në mungesën e pëlqimit të lirë. Gjithashtu, GREVIO nxit autoritetet të parashikojnë në legjislacionin penal si vepër penale sterilizimin e detyruar dhe gjymtimin e organeve gjenitale femërore.

Lidhur me ndalimin e proceseve të detyrueshme alternative për zgjidhjen e konflikteve, GREVIO u kërkon autoriteteve të marrin masat e duhura në legjislacion për të përjashtuar në mënyrë të qartë zbatimin e pajtimit gjatë procesit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe për të vendosur parimin se pajtimi nuk mund të jetë i detyrueshëm në procedurat e divorcit, kur dhuna është prezente.

Përsa i përket urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes, GREVIO kërkon nga autoritetet shqiptare të rishikohen dispozitat ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës. Gjithashtu, është e nevojshme integrimi i vlerësimit të rrezikut në procedurën e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes. Autoritetet duhet të sigurojnë ekzekutimin efektiv të UMM-ve dhe UM-ve nga ana e agjencive përgjegjëse, në veçanti përmbauesve; të ndjekin penalisht dhunuesit që shkelin urdhrat e mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhrat e mbrojtjes, të zbatojnë dënimet penale përkatëse si dhe të nxjerrin para përgjegjësisë nëpunësit që nuk zbatojnë UMM dhe UM.

RRJETI I MONITORIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE do të monitorojë në mënyrë progresive zbatimin e rekomandimeve të GREVIO-s për Shqipërinë si dhe do të llobojë dhe advokojë me autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.